



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.468/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Fitore Bojku, në lëndën penale kundër të pandehurit S. D, sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë, PP/II. nr.390/16 të dt.25.5.2016, për shkak të veprës penale: falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 2, të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit S. D dhe të prokurorit të shtetit Esad Muharremi, me dt.13.03.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri S. D, i lindur me dt.28.7.1977, në fsh. G, K e P, ku edhe tani jeton, i biri i T dhe nënës D, e gjinisë K, Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me datë 29.5.2012 në QRA , në Pejë , me dije ka përdorë dokument publik të falsifikuar, duke e ditur se është i tillë dhe atë lejen e qarkullimit SRB me numër serik CP-07579472, në atë mënyrë që i pandehuri duke përdorë lejen e qarkullimit me karakteristikat të shënuara si në lartë, nxjerrë lejen e qarkullimit RKS për veturën “Volkswagen Golf” , me targa ----- , e në emër të tij ashtu që gjatë ekzaminimit të lejes së qarkullimit SRB me numër CP-07579472 nga ana e sektorit për ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve është konstatuar se leja në fjalë është totalisht e falsifikuar .

-me çka ka kryer veprë penale : falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par 2 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 398 par 2 të KPRK –së I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 15 euro.

Lejen e qarkullimit me numër serik CP-07579472 –KONFISKOHET

Shpenzime procedurale nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.25.5.2016 kundër të pandehurit S. D, ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.390/16 për vepër penale : falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par 2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza, është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë, gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit, lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese, me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi dokumentet e konfiskuara është marrë konform nenit 62 par 2 pika 2.7 dhe 69 të KPRK-së

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 13.03.2017.

Sekretarja juridike

Fitore Bojku

Gjyqtari

Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet

Ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë

E përmes kësaj Gjykate .